



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Medain Hashani	19.07.2023	23.07.2023	2023/0472

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.07.2023, OE “ALBKOS SAFETY SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0472, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “ALBKOS SAFETY SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim dhe servisim i aparateve per fikjen e zjarrit” me nr. të prokurimit: "615-23-5360-1-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: pun?, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: xx,xxx €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0472 i dt:06.07.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Në bazë të pretendimeve ankimore, të dorëzuara nga ana e ankuesit në këtë rast, konstatohet se:

1. AK ka përdorur kriter të gabuar vlerësimi, duke përcaktuar “çmimi më i ulët për njësi me poentim”, i cili zbatohet vetëm në ato raste kur nuk dihen sasi të.

2. Një numër i madh i artikujve i paraparë me këtë tender është i karakterit fiktiv, gjë që mund të konstatohet nga çmimet e ofruara nga OE i propozuar për t’u shpërblyer me kontratë, i cili ka pasur kontratën e fundit për servisimin e aparateve për shuarjen e zjarrit me këtë AK dhe e di saktë se cilët artikuj kërkojnë e cilët jo. AK është dashur të veprojë në përputhje me Nenin 8 të LPP, të planifikojë me kohë pajisjet me të cilat ka pasur nevojë të furnizohet dhe të jep sasi të indikative, kurse sa i përket

pajisjeve që duhet servisuar, ato dihen 100% (bazuar në faturimin e fundit nga OE).

3.Nëse i krahasoni çmimet e servisimit të OE të propozuar për ta shpërblyer me kontratë, me çmimet e ofruar nga ne, atëherë çmimi ynë është më i ulët, andaj fitues është dashur të shpallemi ne.

KRITERET PËR VLERËSIM

Në bazë të njoftimit për kontratë të datës 26.05.2023, kriter për dhënjen e kontratës ka qenë çmimi më i ulët.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Në komisionin vlerësues kanë qenë këta zyrtar: Rrahim Berisha, Makfirete Zuka, Rafet Hasani. Në bazë të këtij raporti të komisionit vlerësues është konstatuar se kanë ofertuar dy ofertues pra PROGLOBAL SHPK, 811500794 dhe ALBKOS SAFETY SHPK 811440908. Në bazë të vlerësimit të ofertave nga Komisioni ka rekomanduar se kriteret për dhënjen e kontratës i ka plotësuar ofertuesi PROGLOBAL SHPK, 811500794 sepse në bazë të kriterit për dhënien e kontratës ka pasur çmimin më të ulët, pra ofertuesi PROGLOBAL SHPK, 811500794 me çmim me TVSH 24.32 € ndërsa ofertuesi tjetër ALBKOS SAFETY SHPK 811440908 me çmim me TVSH 83.04 €.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

-

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

-

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Me datën 19.06.2023, ka pasur vendim të mëparshëm nga ana e PSH-së lidhur me raste të ngjashme, ku pikërisht ankuesi në këtë rast ALBKOS SAFETY SHPK 811440908, ka bërë ankesë në PSH dhe vendimi i PSH-së ka qenë aprovim i pjesërishtëm i bazuar. Vendimi nr.2023/0281. Ky vendim i'u është bashkangjitur ankesës nga ana e ankuesit.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

-

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - ALBKOS SAFETY SH.P.K.

Bazuar në kërkesat për pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me çështjen në fjalë do të përgjigjem sipas pikave të potencuara tek pozicioni dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore:

1.Meqenëse kemi të bëjmë me furnizim për të cilin dihet sasia Autoriteti Kontraktues do të duhej që të zbatoj Nenin 8 dhe mbi bazën e këtij neni të specifikoj edhe sasi të sipas Nenit 28 në mënyrë që të implementohet në tërësi neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

2.Pretendimet e ankuesit se disa artikuj janë paraqitur në mënyrë fiktive, nuk mund të konstatoj njëjtë me ankuesin sepse nuk mund të pretendohet në mënyrë paragjyquese. Mirëpo në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka bërë gabim, që nuk i'u është përgjigjur ankuesit lidhur me kërkesën e datës 23.06.2023 për rishqyrtim. Poashtu ankuesi në këtë rast ka sjellur dëshmi të mjaftueshme në lidhje me çmime jo reale në raport me çmimet e tregut, për artikujt e potencuar në ankesë ku kjo vjen edhe si rezultat i mos aplikimit të nenit 7 , nenit 8 dhe nenit 28 të Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

3.Pretendimet e ankuesit se duhet të shpallemi ne fitues nuk qëndrojnë, sepse në këtë rast që nga fillimi e deri në përfundim, nuk është zbatuar ashtu si duhet nga ana e Autoritetit Kontraktues neni 7, neni 8, dhe neni 28 i LPP-së.

Në mënyrë që të kemi një proces më transparent, në të ardhmen rekomandoj që ky proces i prokurimit duhet të anulohet, pra njoftimi për dhënie të kontratës i datës 20.06.2023 me nr të prokurimit 615-23-5360-1-3-6 të kthehet në pikën zero. Në të ardhmen të aplikohet në tërësi nga ana e Autoritetit Kontraktues, Neni 1, Neni 7, Neni 8 dhe Neni 28 i Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**ALBKOS SAFETY SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim dhe servisim i aparateve për fikjen e zjarrit**” me numër të prokurimit: “**615-23-5360-1-3-6**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PODUJEVËS**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**ALBKOS SAFETY SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim dhe servisim i aparateve për fikjen e zjarrit**” me numër të prokurimit: “**615-23-5360-1-3-6**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PODUJEVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PODUJEVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **ALBKOS SAFETY SH.P.K.**



Medain Hashani